

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI  
I SHOQËRISË  
MERO GROUP SHPK**

**THEMELIMI**

**NENI 1 - ORTAKËT THEMELUES**

- 1.1 Shoqëria **MERO GROUP SHPK** themelohet nga Ortaku i Vetëm:

**Stefano Mero**, shtetas italian, lindur më 14.08.1994 në Lecce (LE) Itali, banues në Via Case Sparse Zona Lizza, SNC, Cavallino 73020 (LE), Itali, mbajtës i Kartes se Identitetit me Nr. CA96628HB, me zotësi të plotë për të vepruar;  
I cili me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë krijon shoqërinë si vijon.

**EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE**

**NENI 2 - EMËRTIMI**

- 2.1 Emërtimi i shoqërisë është **MERO GROUP SHPK** (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

**NENI 3 - FORMA LIGJORE**


- 3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjeter në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**NENI 4 - BAZA LIGJORE**

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Akt Themelimi dhe Statut, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore në fuqi.
- 4.2 Për sa nuk është parashikuar ne ketë Statut, do të aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
- 4.3 Çdo mosmarrëveshje që mund të lind në lidhje me zbatimin dhe/ose interpretimin e këtij Statuti, do të zgjidhet nga gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**NENI 5 - PERSONALITETI JURIDIK. KOHËZGJATJA**

- 5.1 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Tiranë, Shqipëri.
- 5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pakufizuar.



## NENI 6 - SELIA

- 6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga Abdyl Frasheri, Ndërtesa 8, Hyrja 7, Ap. 25, 1019 Tiranë.
- 6.2 Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.
- 6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera Shqiptare ose te huaja që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

## NENI 7 - EMBLEMA. VULA

- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemët dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.
- 7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjisacionit shqiptar.
- 7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë emblemën dhe vulën e saj.

## NENI 8 - OBJEKTI


- 8.1 Objekti i veprimitarisë së Shoqërisë do të jetë:  
Ndërtime rezidenciale dhe jo rezidenciale, ristrukturime, gjërrmime, impjante hidraulike dhe elektrike, studio teknike dhe projektimi të ambjenteve të brendshme dhe të jashtme, konsulencë dhe ndërmjetësim, bar, hotel, klube dhe lokale nate, diskoteka, shitje online, agjenci marketingu.
- 8.2 Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër i cili është në përputhje me Ligjet e Republikës së Shqipërisë.

## NENI 9 – KAPITALI THEMELTAR

- 9.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10,000 (dhjetëmijë) LEKE.
- 9.2 Kapitali themeltar përbahet nga 1 (nje) kuote me vlerë nominale 10,000 (dhjetëmijë) LEKE.
- 9.3 Kapitali zotërohet teresisht nga Ortaku i Vetem.
- 9.4 Përgjegjësia e Ortakut shtrihet deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin e Shoqërisë.

## NENI 10 - TRANSFERIMI I KUOTAVE. KUFIZIMET

- 10.1 Kuota e kapitalit është e transferueshme dhe mund të transferohet në çdo moment sipas kushteve dhe afateve të parashikuara nga ligji shqiptar.
- 10.2 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi pjesët e kapitalit në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Asamblesë së Ortakëve.



## ORGANET E SHOQËRISË

### NENI 11 - VENDIMET E ASAMBLESË SË ORTAKËVE

11.1 Asambleja e Ortakëve në përputhje me legjislacionin shqiptar, mund të vendosë, por pa u kufizuar në to, vendimet me poshtë:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre nga administratori ose administratoret, përfshi raportet financiare;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- miratimin e shkrirjes/bashkimit me shoqëri të tjera;
- ndryshimin e statutit të shoqërisë;
- ndryshimin e selisë dhe të emërtimit të shoqërisë;
- emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se është e nevojshme;
- rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- shitjen ose transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar palëve të treta;
- ristrukturimin dhe prishjen shoqërisë;
- emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë;
- miratimin e pasqyrave financiare të shoqërisë dhe raportit te administrator(eve);
- vendimin për shpërndarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve;
- transformimin e shoqërisë në formë të tjera;
- dhe çdo lëndë tjetër të parashikuar nga Statuti ose nga ligji.

### NENI 12 - ADMINISTRIMI

12.1 Administrimi i shoqërisë do te kryhet nga një ose më shumë administratorë që emërohen me vendim të Asamblesë së Ortakëve.


Në rast se Shoqëria do të administrohet nga më shumë se një administrator, atëherë Administratorët mund t'i ushtrojnë kompetencat bashkërisht ose veçmas sikurse do të përcaktohet në vendimin përkatës të Asamblesë së Ortakëve.

12.2 Administratori i parë i shoqërisë është:

**Z. Stefano Mero**, shtetas italian, lindur më 14.08.1994 në Lecce (LE) Itali, banues në Via Case Sparse Zona Lizza, SNC, Cavallino 73020 (LE), Itali, mbajtës i Kartes se Identitetit me Nr. CA96628HB.

12.3 Administratorëve u jepen te gjitha kompetencat e përcaktuara nga legjislacioni i Republikës se Shqipërisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to, Administratoret janë përgjegjës për veprimitaritë e mëposhtme:

- drejtimin e veprimitarisë së përditshme të shoqërisë;
- përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëni me të tretët personalisht ose me përfaqësim;
- hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
- përgatitjen e dokumenteve në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zotëron;
- të lidhë kontrata për dhe në emër të shoqërisë me palë të treta, të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm për mbarëvajtjen e aktivitetit të shoqërisë;
- të përfaqësojë shoqërinë përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankës së Shqipërisë si dhe të kryej çdo transaksion bankar në emër të shoqërisë;
- të ndërmarrë çdo veprimitari tjetër, ose biznes, ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshëm për administrimin efikas të Shoqërisë në Shqipëri.



- 12.4 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për pesë vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- 12.5 Administratori i Shoqërisë mund t'i transferojë çdo personi apo grupei personash të gjitha apo një pjesë të kompetencave të tij sipas këtij Statuti dhe me kushtet që ai konsideron si të arsyeshme dhe në çdo kohë mund të anullojë ketë transferim kompetencash.

#### **NENI 13 - VITI FINANCIAR**

- 13.1 Viti finansiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.
- 13.2 Përjashtimisht, viti i parë finansiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

#### **NENI 14 - BILANCI. KONTABILITETI.**

- 14.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatumore dhe Qendrës Kombëtare të Regjistrimit deri në fund të muajit Mars to cdo viti pasardhës.
- 14.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave te legjisacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitudit.
- 14.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekoje pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

#### **NENI 15 - TE ARDHURAT, DIVIDENDI**


- 15.1 Shoqëria mund të krijojë fonde rezerve për realizimin e qëllimeve të aktivitetit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 15.2 Fitimet që do të rezultojnë në fund të mbylljes së çdo viti ushtrimor, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahan nga Asambleja e Ortakëve.
- 15.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo ortak do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

#### **NENI 16 - LIKUIDIMI**

- 16.1 Likuidimi i Shoqërisë si dhe emërimi i likuidatorit(eve) bëhet ne përputhje me ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe çdo ligj tjetër të zbatueshëm.

#### **NENI 17 - MOSMARRËVESHJET**

- 17.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.




**NENI 18 - KLAUZOLË MBYLLËSE**

18.1 Ky Statut hartohet në 3 (tre) ekzemplare me fuqi të njëjtë ligjore.

**ORTAKU I VETEM**

**Stefano Mero**

Stefano Mero 

Date 15/02/2022